



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës-Rahovec

Skupština Opština Rahovec / Municipality of Rahovec
REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I KOMUNES / SKUPSTINA OPSTINE / MUNICIPAL ASSEMBLY

RAHOVEC / ORAHOVAC

01 Nr. 01/22
Rahovec, 14.01.2022

Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)
Nr./Br./No 01/254 Nr. i faq/Br.str/No.pg 1
Data/Datum/Date 19.01.2022

Ftohen anëtarët e Kuvendit Komunal, që të marrin pjesë në mbledhjen e cila do të mbahet më **25 janar 2022 (e marte)**, me fillim në orën 10:00, në sallën e KK Rahovec.

Për këtë mbledhje propozoj këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara;
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për themelimin e Komiteteve obligative;
3. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për themelimin e Komitetit për Politik dhe Financa;
4. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për themelimin e Komitetit për Komunitete;
5. Shqyrtimi dhe aprovimi i vendimit për Themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB-së);
6. Shqyrtimi i Raportit vjetor Financiar i Komunës së Rahovecit për vitin 2021.
7. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;

KRYESUESI I KUVENDIT

Deftim Kafexhiu

REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I KOMUNES - MUNICIPAL ASSEMBLY
RAHOVEC / ORAHOVAC



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



PROCESVERBAL

Nga mbledhja inauguruese e kryetarit të Komunës dhe asamblistëve të Kuvendit të Komunës së Rahovecit, e mbajtur më **03.12.2021**, me fillim në ora **10:00**. Mbledhjen e kryesoi: Kuvendari me i vjetër i legjislaturës së re z. **Rasim Fazliu**, i cili dhe propozoj këtë:

REND DITE

- 1. Dhënia e betimit nga anëtarët e Kuvendit të Komunës së Rahovecit,**
- 2. Dhënia e betimit të Kryetarit të Komunës së Rahovecit z. Smajl Latifi**

Para se me procedua me tutje me rendin e ditës, më lejoni që të përshëndes kryetarin e komunës së Rahovecit z. Smajl Latifi, kryesuesin e kuvendit komunal z. Afrim Dina, përfaqësues të OSBE-së, të LMT-së, familjarët e dëshmorëve, drejtorin e stacionit policor në Rahovec z. Fazli Morina, përfaqësuesit e shoqatave të dala nga lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, përfaqësuesit e klerit fetar, që e përshëndes kryetarin e bashkësisë islame në Rahovec, efendi Shani Sylka, i përshëndes kryetarët e këshillave të fshatrave që na kanë nderuar me pjesëmarrjen e tyre, drejtorët e shkollave dhe gjithë mysafirët e pranishëm në sallë dhe gjithë qytetarët e komunës së Rahovecit.

Tani më duhet të lexoj ligjin Nr.03 L 040, dhënia e betimit të anëtarëve të kuvendit të komunës që është e përcaktuar me nenin 35, pika 3,4 dhe 5 e ligjit për vetëqeverisje lokale. Fillimisht më duhet të verifikoj listën e kandidatëve që janë prezentë dhe në momentin që ja thërras emrin të gjithë kandidatet duhet të deklarohen me ngritje të dorës. Pas verifikimit të mandateve, i ftojë anëtarët e kuvendit që të bëjnë betimin.

DEKLARATA E BETIMIT

Unë, Rasim Fazliu, “betohem (ose deklaroj solemnisht) se do t’i kryej me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do ti ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Rahovecit, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë”.

Tani e ftojme kryetarin e Komunës z. Smajl Latifi që të bëjë betimin para anëtarëve të kuvendit.

BETIMI I KRYETARIT

Unë Smajl Latifi, betohem që do ti kryej detyrat dhe do ti ushtroj kompetencat si kryetar i komunës së Rahovecit me nder, besnikëri, në mënyrë të paanshme, me ndërgjegje dhe në pajtim me ligjin në mënyrë që të siguroj kushtet për jetë të qetë për të gjithë.

KRYETARI – Të nderuar anëtarë të zgjedhur të Kuvendit Komunal të Rahovecit, familjarë të dëshmorëve, organizata të dala nga UÇK, përfaqësues fetarë, përfaqësues të shoqërisë civile, afaristë, fermerë e punëtorë, studentë të rinj, të nderuar të pranishëm, ju përshëndes të gjithëve!

Të respektuar qytetarë të komunës së Rahovecit,

Është nder i madh dhe njëkohësisht përgjegjësi e madhe të dal sot para jush në këtë ceremoni solemne për të thënë disa fjalë, që nuk janë fjalë vetëm ceremoniale. Në fillim duhet të falënderoj të gjithë ata qytetarë që me vullnetin e tyre të lirë i kontribuuan procesit demokratik zgjedhor, si dhe subjektet pjesëmarrëse në garën politike për korrektësinë e treguar në këtë proces.

Në raste të tilla është e udhës që të zotohemi, edhe solemnisht se, do të jem i përkushtuar maksimalisht t'ju shërbejë me nder, përgjegjësi, transparencë dhe llogaridhënie. Sistemi ynë politik ofron mundësi dhe hapësira për bashkëpunim institucional dhe përmbushja e këtij obligimi ofron përparësi të mëdha për qytetarët. Kultivimi i raporteve korrekte kolegiale, respektimi i mendimit ndryshe dhe përqaftimi i propozimeve të dobishme, përbëjnë bazën e një demokracie funksionale.

Bashkëpunimi i ekzekutivit komunal me Kuvendin e Komunës është ndër detyrat tona dhe nënkupton respekt për vetë qytetarët. Përbërja diverse e Kuvendit është pasuria jonë e përbashkët dhe propozimet, idetë e pikëpamjet e kuvendarëve do të ndikojnë në ruajtjen e bilancit qeverisës. Bashkërisht mund të arrijmë suksese të dukshme dhe ne të gjithë jemi të interesuar që përpjekjet e angazhimit tona të ndikojnë në përmirësimin e jetës së qytetarëve tanë.

Qeverisja e mirë, demokratike, transparente dhe llogaridhënëse përmbush në masë të madhe kërkesat dhe nevojat e qytetarëve, prandaj do të vazhdojmë përpjekjet e vendosura që të dalim faqebardhë para qytetarëve tanë.

Të gjithë e duam një komunë të fortë, të zhvilluar, të përparuar dhe që qytetarët tanë të ndjehen të përmbushur, të respektuar dhe krenarë që i takojnë kësaj komune me njerëz të veshëm e punëtorë. Përmbushja e këtyre pritjeve është obligimi ynë moral e institucional, bazuar në një program të qartë dhe të analizuar me kujdes. Arritja e këtyre synimeve do të bëhet në përputhje me zotimet publike që i kemi dhënë, i vetëdijshëm se për këtë kërkohet punë e përkushtim i madh. Dua ta bëj të qartë se do të punojmë shumë për të evituar vonesat e pengesat që mund të na dalin në rrugë, sepse dëshira jonë për përmirësimin e kushteve të jetës e të punës për qytetarët tanë është e madhe dhe ne jemi të vendosur në këtë rrugëtim.

Ndër prioritetet tona kryesore do të vazhdojmë të jetë bujqësia, pasuar nga ekonomia dhe përkrahja e prodhuesve, agroturizmi dhe krijimi i kushteve për punësim, përmes industrisë së agropërpunimit.

Do të punojmë për administratë bashkëkohore, me shërbime të shpejta dhe cilësore, si dhe do të përkujdesemi që Arsimi, Shëndetësia dhe Përkujdesja sociale të jenë ndër çështjet ku do të fokusohemi me përkushtim e seriozitet.

Në mandatin tonë të radhës vreshtarët do të vazhdojnë të trajtohen me respekt, duke ofruar ofruar mbështetje konkrete materiale e teknike, si dhe përpjekje të vendosura për sigurimin e tregut të rrushit e të verës, brenda dhe jashtë vendit.

Infrastruktura publike do të ketë prioritet, ashtu si edhe angazhim i përqendruar për mirëmbajtjen e gjithë asaj që është bërë e do të bëhet.

Të rinjtë do të zënë vend të veçantë në angazhimet tona institucionale, sepse funksionalizmi i potencialeve të tyre mendore, intelektuale e fizike, përbën bazën për ardhmërinë më të mirë të këtij vendi. Përfshirja e tyre në vendimmarrjen komunale dhe krijimi i hapësirave rekreative, sigurimi i objekteve moderne për shpërfaqjen e talenteve të të rinjve, do të ketë ndikim në zhvillimin e gjithmbarshëm shoqëror.

Komuna e Rahovecit ka potencial të pashfrytëzuar të turizmit rural apo Agroturizmit, prandaj fokusi ynë në këtë sektor do të jetë i vazhdueshëm. Bukuritë natyrore të Rahovecit, por edhe prodhimet e bollshme e cilësore bujqësore, e favorizojnë këtë sektor. Në këtë mënyrë do të punojmë shumë që Rahovecin ta shndërrojmë në destinacion të preferuar për turistë nga Kosova, por edhe nga bota. Gjatë mandatit të ri, do ta kemi planin e konkretizuar për ta zhvilluar këtë sektor, që mund të jetë fitimprurës për komunën dhe qytetarët.

Do të vazhdojmë me rregullimin e rrugëve fushore, që bujqve t'u krijohet qasje më e lehtë në arat dhe fushat e tyre bujqësore. Po ashtu, do të vazhdojmë me përkujdesjen për ambientin, duke rikultivuar deponitë e pastruara, pyllëzuar hapësirat e përshtatshme dhe duke ndërtuar parqe të reja nëpër lagjet dhe fshatrat e komunës sonë. Do ecim me plane të qarta edhe në arsim, të cilat pashmangshëm do të reflektojnë rezultate të ndjeshme në mësimdhënie.

Kur i përmendim harta e sakrificës dhe vlerat e lirisë, përveçse në nderim e respekt të tyre, kemi planet edhe tona për t'i ruajtur e institucionalizuar ato.

Gjej rastin t'ju them se kontakti me qytetarët dhe debati me ta është rikthyer në planet tona, përditshmëria jonë, si një komponentë e vizionit që do të garantojë pushtet transparent, demokratik dhe në shërbim të qytetarëve.

Për përmbushjen e këtyre zotimeve jemi të vetëdijshëm se kërkohet një bazë më e gjerë e konsultimeve me ekspertë të fushave të ndryshme, debate e takime me qytetarë e me shoqërinë civile, takime e debate publike me grupet e interesit, si dhe me pakicat etnike e me grupe të marginalizuara. Me një fjalë, debati konstruktiv do të jetë baza e qeverisjes tonë. Përfshirja e potencialeve ekzistuese në hartimin dhe zbatimin e politikave zhvillimore, përbën elementin më të rëndësishëm të zhvillimit të gjithanshëm socio-ekonomik të komunës së Rahovecit.

Natyrisht se të gjitha këto nuk do të mund të realizohen nëse nuk arrijmë të sigurojmë bashkëpunim të mirë me Qeverinë e Kosovës, me donatorët e brendshëm e të jashtëm, por mbi të gjitha me qytetarët tanë.

Të nderuar të pranishëm,

Të gjitha këto nuk janë vetëm fjalë boshe, por zotime që do të përmbushen me punë e përkushtim, disiplinë dhe angazhim maksimal të administratës civile komunale.

Bashkë mund të arrijmë rezultate të jashtëzakonshme, prandaj na priftë e mbara!

Faleminderit për praninë dhe mbështetjen tuaj! Ju uroj mbarësi dhe suksese!

Rasim Fazliu – E falënderojmë kryetarin z. Smajl Latifi dhe i urojmë mandatin e ri dhe gjithashtu shfrytëzoj rastin që edhe anëtarëve të rinj të Kuvendit Komunal të ju uroj mandatin dhe ju dëshiroj punë të mbarë dhe suksese në të mirë të qytetarëve të komunës së Rahovecit. Pra me kaq e përfundojmë këtë mbledhje solemne.

Faleminderit të gjithëve për praninë tuaj.

Procesmbajtësi:

Agim Hoti

K R Y E S U E S I

Defrim Kafexhiu



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **22.12.2021**, me fillim në ora **10:00**. Mbledhjen e kryesoi anëtari me i vjetër i Kuvendit z. **Rasim Fazliu**. Konstatohet se kuorum, për mbajtjen e mbledhjes kemi, fillimisht e përshëndes Kryetarin e Komunës z. Smajl Latifi, anëtarët e Kuvendit Komunal, përfaqësues të mediave dhe gjithë të pranishmit në sallë. Sot kemi një pikë të rendit të ditës:

REND DITE

1. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Rahovecit.

Të nderuar anëtarë të Kuvendit, tani duhet të bëni propozimet për kandidat për kryesues të kuvendit të Komunës së Rahovecit. Paraprakisht duhet të ju kujtoj se si duhet të jetë procedura për zgjedhjen e Kryesuesit, që unë mendoj se do të ishte mirë edhe njëherë shefi i zyrës ligjore të na jap njoftimin se si duhet të shkoj procesi për zgjedhjen e kryesuesit.

Isak Hoti – Faleminderit kryesues, kryetar, delegat të nderuar dhe gjithë ju të pranishëm. Konform udhëzimit administrativ Nr.2009/01 udhëzimi administrativ për procedurën e zgjedhjes së kryesuesit të kuvendit të komunës, që po e citoj komplet udhëzimin: ku secili subjekt politik, nismë qytetare apo kandidat i pavarur i përfaqësuar në kuvendin e komunës ka të drejtë që në radhët e anëtarëve të kuvendit të komunës të propozoj një anëtar për kryesues të kuvendit të komunës. Kuvendi i komunës me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të komunës formon komisionin për mbarrëvajtjen e procesit të votimit, i cili përbëhet nga 3-5 anëtarë. Komisioni për votim është përgjegjës që ti numëroj votat dhe të komunikoj për rezultatet e votimit para anëtarëve të kuvendit. Votimi për zgjedhjen e kryesuesit të kuvendit të komunës bëhet me votën e fshehtë. Për të zgjedhur në votimin e parë kandidati i propozuar për kryesues të kuvendit të komunës duhet të marrë më shumë se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të kuvendit. Nëse pas votimit të parë asnjëri prej kandidatëve të propozuar për kryesues të kuvendit të komunës nuk merr më shumë se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të kuvendit të komunës atëherë dy kandidatet të cilët kanë fituar numrin më të madhe të votave shkojnë në votimin e dytë. Kandidati që merr më shumë se gjysmën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të kuvendit të komunës atëherë në rundin e dytë zgjidhet kryesues i kuvendit të komunës. Pika e 4, nëse edhe pas votimit të dytë asnjëri nga kandidatët nuk ka fituar shumicën e kërkuar si në pikën 3 të këtij udhëzimi administrativ atëherë shkohet në votimin e tretë dhe në votimin e tretë kryesuesi i kuvendit të komunës zgjidhet kandidati i cili merr më shumë se gjysmën e votave të anëtarëve të përhershëm dhe që votojnë në propozimin në mbledhjen e kuvendit të komunës. Atëherë nëse edhe në votimin e tretë nuk zgjidhet kryesuesi i kuvendit të komunës atëherë i tërë procesi për zgjedhjen e kryesuesit të kuvendit të komunës përsëritet dhe fillon prapë nga e para. Gjithashtu më duhet të potencoj se datën 3 janar kemi ditën e fundit për zgjedhjen e kryesuesit të kuvendit të komunës.

Rasim Fazliu – E falënderoj shefin e Zyrës Ligjore për të gjitha sqarimet që i dha, kështu që tash është radha e propozimeve dhe ju ftoj të jepni propozimet tuaja.

Fatmir Iska – Përshëndetje i nderuar kryesues i seancës së kuvendit z.Rasim Fazliu, kryetar i komunës, kolegë kuvendarë dhe gjithë ju të pranishëm në sallë. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës edhe në seancën e kaluar e ka propozuar z. Afrim Dina, kështu që ne prape vazhdojmë që ta kemi kandidat për kryesues, si një pedagog i mirë dhe si kryesues i kuvendit në mandatin e kaluar që e ka menaxhuar punën shumë mirë, kështu që ju ftoj të gjithëve pa dallim me përkrah dhe me mbështet për kryesues të kuvendit komunal në mandatin 2021-2025.

Leonard Morina – Përshëndetje kryesues, kryetar dhe gjithë të pranishmit në sallë. Levizja Vetëvendosje kandidat për kryesues e ka Defrim Kafexhiu, një djal i zellshëm, punëtor dhe besoj që nuk do të ju zhgënjë, kështu që ju ftoj që pa dallim ta mbështetini kandidaturën e tij.

Rasim Fazliu – Faleminderit, a ka dikush tjetër rreth ndonjë propozimi, kështu që siç po shihet nuk ka kandidat tjetër. Atëherë për formimin e komisionit, shefi i zyrës ligjore tregoj se duhet të jenë 3-5 anëtarë të komisionit, kështu që duhet të vendosim se a do të kemi 3 apo 5 anëtarë të komisionit.

Ali Morina – Faleminderit kryesues, si grup i aleancës për ardhmërinë e Kosovës propozojmë që në komision për zgjedhjen e kryesuesit të jenë 5 anëtar.

Leonard Morina – Ne mendojmë që meqenëse jemi 4 subjekte politike atëherë duhet me qenë 4 anëtar për komision, mirëpo pasi që duhet me qenë tek atëherë edhe ne jemi për 5 anëtarë.

Rasim Fazliu – Atëherë propozoj me ngritje të dorës që ta shohim se kush është për 5 anëtarë në komision. Kështu që shumica janë për 5 anëtarë dhe menjëherë fillojmë me propozimin për anëtar të komisionit.

Ali Morina – Faleminderit kryesues i seancës, i nderuari kryetar, të nderuar kolegë asamblistë. Pasi që jemi edhe grupi më i madh i asamblistëve, besoj që ne përbërjen prej 5 anëtarëve të komisionit, neve na takojnë 2 anëtarë brenda këtij komisioni, andej edhe ne emër të grupit të aleancës për ardhmërinë e Kosovës propozojmë Besmire Bytyqi dhe Feriz Thaqi.

Burim Krasniqi – Unë po besoj që komisioni nuk ka diçka specifike apo të veçantë për me pas ndarje apo përfaqësim politik, kështu që kërkoj që secili grup me dhanë nga një kandidat për anëtarë të komisionit dhe një me qitë nga administrata që me i ndihmua procesit, pra secili subjekt politik me propozua nga një emër dhe një nga administrata që me i ndihmua teknikisht dhe besoj që gjithçka është në rregull pasi nuk ka ndonjë vlerë ajo që cili subjekt i vendos 2 apo më shumë emra.

Isak Hoti – Me keqardhje ju them por administrata është për me i krye punët që i takojnë me çështjet administrative kurse pjesën tjetër ju takon juve si politikë.

Rasim Fazliu – Ju vet u dakorduat se si duhet me qenë numri i anëtarëve të komisionit, kështu që mendoj se nuk është edhe shumë e rëndësishme kjo punë, pasi nëse këta janë dy anëtar atëherë ju i keni tre anëtar dhe jeni të gjithë së bashku aty dhe nuk është e vështirë me bo verifikimin e votave.

Merisa Sharku-Vuçitërna – Përshëndetje për të gjithë. Për anëtar të komisionit e propozojmë Ilir Pallqën.

Burim Krasniqi – Për anëtar të komisionit e propozojmë Faton Ramadanin.

Bejtullah Deliu – Për anëtar të komisionit e propozojmë Melinda Iska.

Rasim Fazliu – Pra e kemi të formuar komisionin prej 5 anëtarëve.

Besmire Bytyqi, Feriz Thaqi, Ilir Pallqa, Faton Ramadani, Melinda Iska.

Tani do ta bëjmë verifikimin e anëtarëve prezent që janë të pranishëm në sallë. Pas verifikimit të anëtarëve, komisioni konstaton se prej 31 asamblistëve të zgjedhur, në seancë mungojnë Fahrije Lushi-Morina dhe Masar Popaj. Pra prezentë në sallë janë 29 asamblistë.

Deri sa sekretari i kuvendit të përgatis fletat e votimit me kandidat e propozuar për kryesues të kuvendit, ne mund të bëjmë pauzë 10 minuta dhe me pastaj fillojmë me votimin.

Rasim Fazliu – E falënderoj sekretarinë e kuvendit për përgatitjen e fletëvotimeve dhe gjithashtu e ftoj një anëtar të komisionit që të vij ti marr fletëvotimet dhe të bëj verifikimin e tyre.

Burim Krasniqi – A precizon udhëzimi administrativ formën e votimit, a shkruan diku në udhëzim se si votohet sikurse qysh është e përcaktuar në procese të tjera.

Isak Hoti – Në Republikën Kosovës në 36 komunat nuk ekziston një fletëvotim unik por në bazë të praktikave të komunave tjera është kështu si e kemi bërë ne, pasi nuk thotë që duhet apo nuk duhet të vendoset shenja katror. Ju keni të drejtë me rrumbullakosua numrin 1 apo 2, po ashtu keni të drejtë me rrumbullakosua komplet emrin, keni të drejtë me rrumbullakosua vetëm subjektin dhe vota është e vlefshme. Në fund shkruan se të rrumbullakohet vetëm numri i kandidatit tuaj dhe mendoj se asgjë të keqe nuk ka.

Bejtullah Deliu - E thoni vetëm numrin e ndërkohë e shpjegove se mundesh subjektin mundesh emrin dhe po ndryshon jashtë kësaj që ju e keni cekur. Pra, tani po ndryshon prej asaj që keni shkruan dhe shpjegimi juaj dallon prej asaj që shkruan aty.

Isak Hoti – Nëse thotë diku që ke të drejtë me vizatua në fletëvotim do të marr përgjegjësinë unë.

Burim Krasniqi – Meqenëse udhëzimi nuk e precizon pavarësisht praktikave që realisht ato edhe munden me u ndërrua atëherë unë po kërkoj me qit një propozim timin. E para me qenë vetëm emrat e të propozuarve dhe jo të subjekteve politike, se janë delegat të kuvendit të komunës të propozuar, nënshkruhet Afrim Dina dhe Defrim Kafexhiu, dhe sigurisht me largue emrat e subjekteve politike, pasi janë dy emrat e delegateve që kanë të drejtën e kandidimit. Pastaj, po kërkoj që fletëvotimi me pas edhe katrorin dhe brenda katrorit të votohet dhe sigurisht mundet edhe jashtë katrorit me rrumbullakësua emrin apo numrin që për mua do të ishte valide dhe si të tillë e kam në propozim që e para fletëvotimi të mos e ketë subjektin politik dhe e dyta fletëvotimi të ketë edhe katrorin për votim dhe kërkoj me qitë në votim.

Isak Hoti – E para e punës largimi i subjekteve nga fletëvotimi është e papranueshme, për vet faktin se nuk ka koalicion apo koalicion të përbashkët dhe ju keni me pa në vazhdimësi dhe në formimin e komisioneve që kanë me u krijuar siç janë obligative Komiteti për Politikë dhe Financa, Komiteti për Komunitete dhe gjitha komisionet e tjera e kanë në çdo vendim ka me shkruar edhe subjekti politik, pasi ky vendim ka me shkruar për certifikim në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit lokal, që do të thotë se subjekti nuk largohet. Mirëpo a ka mundësi me ma dhanë një arsye se pse nuk duhet të jenë numrat 1 dhe 2 pasi dhe në të gjitha legjislaturat kemi shkruar zakonisht kështu.

Defrim Kafexhiu – Meqenëse ne po veprojmë në bazë të praktikave të kaluara dhe të kuvendeve tjera të kuvendeve komunale, unë po besoj që ne duhet me qenë shembull dhe pasi ne po veprojmë në bazë të praktikave mundemi me marr si shembull fletëvotimin që KQZ-ja që e bën dhe pse mos me pas një katror afër emrit dhe në bazë të kësaj numrat nuk do të ishte mirë me figurua kur janë dy emra dy katrorë atëherë pse 1 dhe 2.

Kryetari – Përshëndetje për kryesuesin e kuvendit, anëtarët e kuvendit, monitoruesit e kuvendit dhe gjithë të pranishmit në sallë. Për çështje teknike nuk e kam në plan as me diskutua por po besoj që grupi i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës si grup e kanë propozua kandidatin dhe ka me figurua AAK. Kështu që me udhëzim administrativ thotë që në qoftë se një asamblist i pavarur, një iniciativë e një grupi etj kështu që është çështje thelbësore politike kurse ata që kanë një kandidat të përbashkët ose një kandidat të pavarur le të ja heqin siglën e partisë kurse unë pasi që jam edhe kryetar i partisë i ftoj që mos me ja heq siglën e partisë.

Rasim Fazliu - Të nderuar anëtarë të kuvendit, konsideroj që fletëvotimi pasi nuk jemi për herë të parë në zgjedhje dhe shumë e logjikshme është propozimi që katrori duhet me qenë të numri, pasi nuk e dëmton asnjërin palë dhe kjo është rregull pasi ne të gjitha fletëvotimet e zgjedhjeve janë katrorët. Komisioni është i përbërë prej 5 anëtarëve dhe anëtarët e komisionit kanë me verifikua çdo fletëvotim dhe në qoftë se ne

fletëvotim ka parregullsi apo janë të rrumbullakuar dy emra atëherë automatikisht e shpallin të pavlefshëm, por nuk ka vend për diskutime dhe duhet bëhen fletëvotime të reja dhe të vendoset katrori aty pasi flasë në mënyrë parimore nëse dëshironi me i ndjekë rregullat ashtu siç duhet. Kështu që e ftojë sekretarinë e kuvendit që me i shtypë fletëvotimet e reja dhe me vendos katrorin aty te numri dhe me pastaj kandidati le te votoj sipas dëshirës dhe me largua vërejtjen aty pasi është ndikim i drejtpërdrejt ne anëtarët e kuvendit.

Isak Hoti – Në kuadratin e bardh apo mbi llogo te subjektit zgjedhor, parti koalicion ose sipas rastit kur zgjedh edhe kandidatin duhet te vendoset shenja X ose +, pasi çdo shenjë tjetër mund ta bëj ta pavlefshëm fletëvotimin.

Burim Krasniqi – Komisioni doli me propozimin që me vendos katrorin pastaj me heqë vërejtjen ne fund, pasi udhëzimi administrativ për zgjedhjen e kryesuesit nuk përcakton simbolin që duhet me qitë. E definove mirë dhe komisioni le ta marrin një qëndrim rreth kësaj ne bazë te rekomandimeve apo kërkesave tona, le ta rekomandon e votojmë asambleja fletëvotimin, e cila nuk është ne kundërshtim me udhëzimin administrativ për zgjedhjen e kryesuesit dhe ne momentin që na duhet atëherë sekretaria na ndihmon.

Leonard Morina – Ne si grup i lëvizjes vetëvendosje jemi që me largua emrin e subjektit LVV, por shenja e katrorit duhet të vendoset patjetër afër numrit në fletëvotim pasi nëse një shenjë vendoset afër dy emrave mund te ketë dilema, kështu që brenda katrorit dihet se për cilin kandidat dhe gjithashtu vërejtja në fund duhet të largohet sepse është shumë e panevojshme, edhe asnjë shenjë tjetër brenda katrorit nuk e shpall të pavlefshme.

Defrim Kafexhiu – Unë vetëm desha me than se është e papranueshme qasja e zyrtarit e zyrtarit ligjor, pasi njëherë tha që kuvendet e bëjnë praktikën dhe komisioni e tregon mënyrën se si me formua fletëvotimin. Kështu që është e papranueshme qasja që njëherë me u thirr ne praktikën e kaluara ose te kuvendeve tjera komunale e me pastaj me u thirr prej komisionit qendror zgjedhor varësisht se qysh i konvenon dhe kjo është e papranueshme dhe e dënueshme kjo qasje e zyrtarit ligjor.

Isak Hoti – Askund nuk e kam përmend as nuk e thash fjalën praktikë, ne bazë te praktikave. Praktikën ne te gjitha komunat behet një fletëvotim i tillë dhe nëse kërkoni ne google për komunat fqinjë se si kanë votuar atëherë do ta shihni të njëjtë një gjë te tillë. Gjithashtu u përmend nga asambleti Burim Krasniqi edhe fletëvotimet e zgjedhjeve të përgjithshme dhe ato lokale zyrtare. Kështu që mbi bazën e kësaj unë e dhashë edhe atë që thuhet në udhëzim administrativ. Kurse sa i përket qasjes time, unë si udhëheqës i sektorit të Zyrës Ligjore ka kush me jep vërejtje, kështu që e imja është që në bazë te procedurës me zhvillua një procedurë të rregullt që mos me lanë këtë kryesues me gabua, përndryshe nëse e shihni të arsyeshme ne mund te dalim si administratë dhe ju mund ta zgjidhni.

Faton Ramadani – Përhëndetje për te gjithë. Si anëtar i komisionit propozoj që para numrave 1 dhe 2 të vendoset edhe shenja e katrorit, pasi s'mund ti diktojmë kandidatet që të votojnë me X,Y apo me ndonjë shenjë tjetër. Gjithashtu ne KQZ thuhet pasi kam punuar një kohë të gjatë si anëtarë i komisionit thuhet që mundet me votue me tik, x apo me çfarëdo shenje tjetër me vendos aty bile mundet edhe emrin me rrumbullakosua apo vetëm subjektin apo edhe vetëm me një pikë që është afër subjektit apo kandidatit. Kështu që propozoj që të vendosin komisioni dhe bëhen fletëvotimet e reja dhe të vendoset katrori në fletëvotim dhe te procedojmë.

Rasim Fazliu – Edhe njëherë po e them se shenja e katrorit do të ishte mirë më qenë mirëpo edhe diçka dua te ju drejtohem të gjithëve dhe vetes sime sigurisht. Para se me ardhë këtu e kemi ndaje mendjen secili se si duhet te votojë pasi edhe ashtu nuk kemi nevojë të merremi me formalitete pasi unë veç e di se çka ka me votue edhe ju sigurisht secili për veten e tij e din se çka ka me votue por sigurisht se shenja e katrorit duhet me qenë patjetër dhe sigurisht se pajtohem edhe unë me propozimin.

Feriz Thaqi – Komisioni ka vendosur që në fletëvotim të vendosen katrorët dhe në vërejtje të shënohet se vetëm në katror duhet të shënohet kurse jashtë katrorit atëherë fletëvotimi është i pavlefshëm.

Rasim Fazliu – Komisioni e ka bërë verifikimin e fletëvotimeve dhe ka konstatuar vërtetësinë e tyre. Kështu që tash fillojmë me votimin dhe unë do të thërras me emra, secilit që i përmendët deklarohet pastaj nënshkruhet dhe merr fletëvotimin dhe shkojnë votojnë në kutinë e votimit. E keni vërejtjen që duhet të votojë brenda katrorit dhe ju kërkoj edhe njëherë që ta keni parasysh mënyrën e votimit që mos të krijohen probleme gjatë vijimit të votimit.

Pas përfundimit të votimit, e ftojë komisionin që të bëjë numërimin e votave. Fillimisht duhet të vërtetohen numri i fletëvotimeve në kutinë e votimit që a janë në përputhje me numrin e anëtarëve që janë të regjistruar.

Feriz Thaqi – Komisioni ka bërë numrimin e votave, kanë qenë 31 fletëvotime, 2 janë eliminuar për shkak se nuk kanë qenë prezentë dhe gjithsej 29 janë të vlefshme dhe asnjë e pavlefshme, 15 vota janë për VV-në kurse 14 AAK-në.

Rasim Fazliu – Pas rezultateve që na dha kryesuesi i komisionit dhe u pa që nuk janë votat e mjaftueshme për të zgjedhur kryesuesin e kuvendit atëherë shkohet në rundin e dytë, kështu që presim sekretarin deri sa të bëjë gati fletëvotimet për rundin e dytë.

Feriz Thaqi – Komisioni ka bërë verifikimin e fletëvotimeve dhe gjithsej janë 31 fletëvotime.

Rasim Fazliu – Fillojmë me votimin e raundit të dytë për zgjedhjen e kryesuesit të kuvendit. Unë do të thërras emrat dhe ju do të deklaroheni dhe do të nënshkruani në listën e nënshkrimeve dhe me pastaj do të merrni fletëvotimin për të votuar në kutinë e votimit.

Feriz Thaqi – Fletëvotime kanë qenë 31 gjithsej, 2 janë larguar për shkak se mungojnë dy asamblistë, 29 ka qenë numri i anëtarëve që kanë votuar dhe 29 janë të vlefshme dhe rezultati është 15 vota për VV-në dhe 14 AAK-në.

Rasim Fazliu – Për shkak se nuk është arritur numrin e duhur që të zgjedhim kryesuesin, duhet të shkojmë në rundin e tretë, por së pari e ftojë sekretarin që të përgatis fletëvotimet për rundin e tretë.

Feriz Thaqi – Komisioni ka verifikuar numrin e fletëvotimeve që janë 31, prej 2 fletëvotime eliminohen për shkak se mungojnë dy asamblistë, kështu që 29 fletëvotime i dorëzohen komisionit.

Ftoj komisionin që të bëjë numrin e votave. Pas numërimit të votave, komisioni ka konstatuar se 14 vota ka marrë kandidati Afrim Dina, 14 vota ka marrë kandidati Defrim Kafexhiu dhe 1 është e pavlefshme.

Ftojë Shefin e Zyrës Ligjore z. Isak Hoti për procedurën e mëtutjeshme.

Isak Hoti – Për shkak të pauzës duhet të presim për gjysmë ore, për shkak se kontakti me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal është paksa i pamundur por gjithsesi nga ajo që shihet duhet të thirret edhe një mbledhje urgjente për sot apo nesër dhe nëse MAPL-ja na jep një udhëzim ndryshe ka mundësi që futemi edhe në rundin e katërt. Kështu që duhet të presim për një pauzë për rreth 40 min.

Në udhëzimin administrativ Nr.2009/1 për procedurën për zgjedhjen dhe përgjegjësin e kryesuesit të kuvendit të komunës janë shtjerr ligjorisht të gjitha mundësitë, kështu që në nenin 3 të votimi dhe zgjedhja e kryesuesit nuk parashihet një rund i katërt dhe në jemi në një situatë që nuk ka as praktikë. Në këtë rast e vetmja mundësi është edhe një mbledhje tjetër në bazë të ligjit për mbledhje urgjente, pasi ligji i parashihet tre mundësi për thirrje të seancës, ku në këtë rast kemi të drejtë të shfrytëzojmë mundësinë e thirrjes së mbledhjes urgjente, pasi nuk kemi të drejtë me vazhdua mbledhjen pasi nuk kemi mundësi me bo praktika të dyfishta, pasi me konsultën me Xhevat Tafën që është drejtor në departamentin për çështje ligjore në MAPL na ka thanë që mundëni me thirr vetëm mbledhje urgjente ose mbledhje të rregull nëse keni kohë dhe ju lejon afati ligjor 7 ditë për material, kështu që në këtë rast përveç mbledhjes urgjente nuk kemi të drejtë me marrë.

Rasim Fazliu – Unë dua të potencoj se kam thënë vetëm në bazë të fjalëve që ju mi keni dhënë dhe unë e respektoj zyrtarin ligjor dhe në bazë të asaj kam thënë që mbledhja duhet të mbyllet mirëpo ju keni insistuar që mundeni me vazhdua dhe tash jemi në një situatë çfarë jemi.

Burim Krasniqi – Meqenëse rregullorja e parasheh që duhet me u përsërit komplet procesi që të shkohet përsëri në 3 raunde, unë po besoj që dhe i rekomandoj secilit që të dakordohemi që qoftë në vazhdim të seancës apo me shkue në seancë të jashtëzakonshme pasi duhet të shkohet në 3 runde të votimit dhe sigurisht se MAPL-ja nuk mundet me than ndryshe nga ajo që shkruan në udhëzim administrativ por nëse ka ndonjë zbrazëti të ligjore në legjislacion që i jep mundësi raundit të katërt atëherë edhe mund të shkojmë në raundin e katërt dhe nëse nuk ka atëherë përsëriten vetëm dakordohemi datën kur do të mbajmë seancën që vazhdohet apo të mbajmë seancë të re, cikli do të përsëritet me 3 raunde.

Isak Hoti – Organ mbikëqyrës për komunat dhe jo vetëm për komunën e Rahovecit është Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, kështu që nuk mundemi me hamendësua dhe nuk mund të themi se kemi të drejtë këtë apo atë, kështu që as juve dhe as kryetarin e komunës prej se jam në punë këtu asnjëherë në lajthitje nuk e kam vënë, kështu që unë nuk guxoj me hamendje me punua dhe arsyetja që kërkova 40 minuta pauzë është që të marr konsultën nga MAPL-ja dhe nëse ata me dërgojnë me shkrim atëherë unë filloj por nëse nuk dërgojnë me shkrim atëherë nuk guxoj me hy në procedurë përpos tentim thirrjes për mbledhje urgjente, por sigurisht vetëm me dërgimin e një shkrese zyrtare.

Rasim Fazliu – E falënderoj zyrtarin ligjor, unë mendoj se anëtarët e kuvendit që jemi këtu i kemi fajet për një situatë të tillë dhe si përfaqësues të qytetarëve që jemi nuk është veprim i mirë dhe nuk jemi në nivelin e duhur.

Afrim Dina – Faleminderit kryesues i mbledhjes. Në bazë të shefit të zyrës ligjore jemi të obliguar me prit që me marr mendimin që na jep MAPL-ja pasi nuk dëshirojmë me bo shkelje ligjore, pasi si cikël kanë përfundua 3 rundet kështu që pauza prej 30-40 minuta është e mjaftueshme dhe në momentin na konfirmojnë atëherë edhe procedojmë tutje, nëse na japin zyrtarisht por nëse ka nevojë për seancë urgjente e bëjmë menjëherë sot apo nesër.

Rasim Fazliu – Pra duhet të presim deri sa Ministria e Pushtetit Lokal të na kthen përgjigje dhe kthehemi në ora 15.00 në sallë të kuvendit.

Procesmbajtësi:

Agim Hoti

K R Y E S U E S I

Afrim Dina



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



PROCESVERBAL

Nga mbledhja urgjente e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **22.12.2021**, me fillim në ora **16:00**. Mbledhjen e kryesoi anëtari me i vjetër i Kuvendit z. **Rasim Fazliu**. Konstatohet se kuorum, për mbajtjen e mbledhjes kemi, fillimisht e përshëndes Kryetarin e Komunës z. Smajl Latifi, anëtarët e kuvendit komunal. Përfaqësues të mediave dhe gjithë të pranishmit në sallë. Sot kemi një pikë të rendit të ditës:

REND DITE

1. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Rahovecit.

Të nderuar anëtarë të kuvendit, kërkoj nga grupet politike që të japin emrat e kandidatëve për kryesues të kuvendit.

Fatmir Iska - I nderuari kryesues i seancës, kryetar, kolegë asamblistë, ne përsëri si grup më i madh politik në kuvend e propozojmë z. Afrim Dina si kandidat për kryesues të kuvendit, që ju ftojme të gjithëve pa dallim partie me përkrah dhe me votue.

Leonard Morina – Përshëndetje për të gjithë. Grupi i Lëvizjes Vetëvendosje përsëri e propozon z. Defrim Kafexhiu.

Rasim Fazliu – Atëherë meqë nuk kemi tjerë të propozuar, tani duhet të formojmë komisionin prej 5 anëtarëve cili do të përcjell mënyrën e votimit dhe verifikimin e fletëvotimeve për kryesues të kuvendit.

Ali Morina – Si grup i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e propozojmë z. Feriz Thaqi dhe znj. Besmire Bytyqi.

Leonard Morina – e propozojmë z. Ilir Pallqa.

Burim Krasniqi – e propozojmë z. Faton Ramadani.

Bejtullah Deliu – e propozojmë znj. Melinda Iska

Isak Hoti – Përshëndetje kryesues i seancës, kryetar, delegatë të kuvendit, media dhe gjithë të pranishmit në sallë. Atëherë siç jemi në dijeni se seanca e rregullt ka shkuar dhe tani jemi në seancë urgjente e cila thirret në bazë të nenit 44 për vetëqeverisje lokale ku cilësohet si mbledhje urgjente. E kemi cilësuar si të tillë për faktin se deri më 3 janar jemi të obliguar me zgjedh kryesuesin, në të kundërtën sipas ligjit komuna jonë duhet të shkojë në zgjedhje. Unë do ta citoj vetëm nenin 44.6, ku thotë se procedurat e lartpërmendura ku flet për mbledhjet e rregullta dhe mbledhjet e jashtëzakonshme, nuk zbatohen për takimet që thirren për shkak të rrethanave urgjente dhe pikërisht për këtë konsiderohet si mbledhje urgjente dhe ne jemi shkuar me procedurë të përshpejtuar në konsultim edhe me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Rasim Fazliu – Atëherë nëse sekretaria e kuvendit është gati me fletëvotime dhe nëse po, atëherë e ftoj komisionin që të përgatitën për mbarëvajtjen e votimit.

Të gjithë anëtarët e kuvendit që janë prezentë votuan dhe tash e ftoj komisionin që të bëjë numërimin e votave.

Besnare Bytyqi – Faleminderit kryesues i seancës, komisioni konstaton se nga 29 fletëvotime, një është e pavlefshme, pra 15 Vetëvendosje dhe 13 AAK.

Rasim Fazliu – Meqenëse ne rundin e parë nuk është plotësuar numri i duhur që duhet që të kaloj me 16 vota, atëherë duhet të shkojmë ne rundin e dytë. Tani e ftojë sekretarin që të bëjnë përgatitjen e fletëvotimeve dhe vazhdojmë tutje me votim. Atëherë fillojmë me votimin në rundin e dytë. Tani ftojë komisionin që të komunikoj rezultatet e votimit të rundit të dytë.

Besnare Bytyqi – Faleminderit kryesues i seancës, pas numrit të 29 fletëvotimeve, deklarojmë dhe konstatojmë se 16 vota janë për Lëvizjen Vetëvendosje dhe 13 për Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës.

Rasim Fazliu – Konstatojmë se kryesues i Kuvendit Komunal është z. Defrim Kafexhiu, që ftojë për një fjalë rasti.

Defrim Kafexhiu – I nderuar dhe shumë i respektuar ish kryesues z. Afrim Dina, i nderuar udhëheqës i seancës z. Rasim Fazliu, i nderuar kryetar i komunës, sekretari e kuvendit, zyrtar ligjor, nderime dhe respekt për kolegun tonë që po lufton për jetën sot ish asamblistin dhe asamblistin aktual nga LDK z. Masar Popaj, të nderuar anëtarë të kuvendit, monitorues të organizatave, media dhe qytetarë të dashur të komunës së Rahovecit. Sot këtu njeri nga anëtarët e këtij kuvendi u zgjodh kryesues i tij. Anëtarët e kuvendit më besuan mua këtë detyrë. Për mua nuk është privilegj, është pak krenari e shumë përgjegjësi. Krenaria zbehet e përgjegjësia rritet atëherë kur e kuptojmë që këtu jemi për të ju shërbyer qytetarëve dhe jemi të zgjedhurit e tij. Të nderuar të pranishëm, këtu në këtë kuvend, nuk fitoj opozita por zuri vend demokracia. Kjo nuk është as humbje e pozitës pasi votoj shumica. Të nderuar anëtar të kuvendit komunal ju falënderoj për zemërsisht për çdo votë tuajën dhe besimin që me keni dhënë mua. U zgjodha kryesues nga ju por unë jam njëri prej jush. Së bashku do të vendosim dhe do të punojmë për të mirën e qytetarëve të komunës tonë. Bashkë do t'i dalim në ballë të keqes dhe do ta ndalojmë atë. Do ti japim edhe do të krijojmë hapësira për zhvillimin e komunës tonë sepse për atë jemi këtu që të ju shërbejmë qytetarëve e të rrugëtojmë bashkë me ta për një jetë të qetë e më të mirë. Një falënderim të veçantë për opozitën e kuvendit komunal të Rahovecit për unifikimin dhe zgjedhjen e tyre. Një kuvend i unifikuar do të thotë një ekzekutiv përgjegjës, andaj kështu përfitojnë më shumë qytetarët dhe besoj se ky është edhe qëllimi i të dyja palëve. Dhe krejt në fund të gjithë anëtarëve të zgjedhur të kuvendit dhe kryetarit njëkohësisht ju uroj një mandat të frytshëm të mirë e produktiv në shërbim të banoreve të komunës tonë dhe qofshi faqebardhe në këtë rrugëtim. Sinqerisht faleminderit.

Rasim Fazliu – Faleminderit dhe urime kryesues i ri kuvendit komunal dhe juve të nderuar asamblistë ju faleminderit për angazhimin që patet dhe me këtë e përfundoj mbledhjen. Faleminderit.

Procesmbajtësi:

Agim Hoti

KRYESUESI

Defrim Kafexhiu



JANAR 2022

KOMUNA E RAHOVECIT - DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

Raporti financiar Janar-Dhjetor 2021



Drejtoria për Buxhet dhe Financa

Përmbajtja

HYRJE.....	2
1. TË HYRAT VETANAKE	3
1.1 Të hyra të planifikuara, të realizuara dhe krahasimi i tyre 2021/2020.....	3
1.2 Të hyrat e rregullta të planifikuara dhe të realizuara në baza mujore 2021/2020 dhe krahasimi i tyre.....	3
1.3 Krahasimi i të hyrave të rregullta të realizuara në baza mujore 2015-2021.....	3
1.4 Krahasimi i të hyrave të realizuara nga gjobat e trafikut dhe gjobat nga gjykatat 2021/2020.	4
1.5 Krahasimi i të hyrave të realizuara sipas kodeve ekonomike 2021/2020.....	6
2. TATIMI NË PRONË.....	7
2.1 Planifikimi dhe realizimi i tatimit në pronë 2021/2020	7
2.2 Shpërndarja e faturave, regjistrimet dhe verifikimet e objekteve në Tatimin në Pronë	7
3. REALIZIMI I BUXHETIT	8
3.1 Shpenzimet sipas programeve (drejtoritë)	8
3.2 Shpenzimet sipas kategorive ekonomike dhe paraqitja grafike	10
3.3 Mallra dhe Shërbime sipas programeve	11
3.4 Mallra dhe Shërbime sipas kodeve ekonomike	16
3.5 Shërbime Komunale	19
4. RAPORTI I KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA	20
5. RAPORTI I OBLIGIMEVE TË PAPAGUARA	22
5.1 Mallra dhe Shërbime.....	22
5.2 Shërbime Komunale	25
5.3 Subvencione	27
5.4 Shpenzimet Kapitale.....	28

HYRJE

Qëllimi i këtij raporti është që të njoftojë Kryetarin, Bordin e drejtorëve, Komitetin për Politikë dhe Financa si dhe Kuvendin Komunal, për realizimin e buxhetit komunal përfshirë buxhetin e secilës Drejtori – Program buxhetor, duke filluar prej programeve të Administratës së përgjithshme, Shëndetësisë primare, Arsimit dhe Shkencë për periudhën Janar – Dhjetor 2021, duke përfshirë kategoritë ekonomike të pagave & mëditjet, mallra dhe shërbimet, shpenzime komunale, subvencione dhe investimet kapitale.

Realizimin i të hyrave komunale-vetjake dhe strukturën e tyre sipas burimeve të tyre, në mënyre analitike, të hyrat nga gjocat e trafikut dhe të gjykatave si dhe krahasimi i tyre në raport me të njëjtën periudhë Janar-Dhjetor të vitit 2021/2020

Buxheti i Komunës për vitin 2021, nënkupton Buxhetin e aprovuar nga Ministria e Financës, respektivisht Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës për vitin 2021, për komunën e Rahovecit, të aprovuar paraprakisht edhe nga Kuvendi Komunal dhe organet e tij.

Prezantimi i të dhënave në këtë mënyrë mundëson:

- Prezantimin e raportit financiar në formë transparente dhe të tërësishme,
- Shikimin e realizimit, respektivisht shpenzimin e mjeteve sipas kategorive (pagave & mëditjet, mallra dhe shërbimet, shpenzime komunale, subvencione dhe investimet kapitale.
- Mundësin e krahasimit në mes fondit të planifikuar, të alokuar dhe të shpenzuar sipas kategorive, se a është tejkaluar-shfrytëzuar apo nuk është shfrytëzuar fondi i planifikuar, alokuar,
- Shprehja në përqindje e shfrytëzimit të buxhetit në periudhën vjetore.

Në këtë mënyrë nga aspekti financiar është e arsyeshme të paraqitet:

- Realizimi i të hyrave vetjake-komunale sipas burimeve,
- Shpenzimet e krijuara sipas kategorive buxhetore,
- Përqindja e realizimit të buxhetit për këtë periudhë kohore.

Të dhënat e poshtë shënuara, sa i përket shpenzimeve për paga, mallra & shërbime, shërbimeve komunale, subvencioneve, investimeve kapitale si dhe regjistrimi i të hyrave, sipas klasifikimit ekonomik janë të harmonizuara me Departamentin e thesarit të Ministrisë për Financa dhe raportet që dalin nga SIMFK - Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar të Kosovës.

1. TË HYRAT VETANAKE

1.1 Të hyra të planifikuara, të realizuara dhe krahasimi i tyre 2021/2020

Përshkrimi	Realizimi 2020	Realizimi 2021	Ndryshimi 2021-2020	Krahasimi 2021/2020
Të hyrat e rregullta	1,182,723.25	1,172,638.98	-10,084.27	(0.85)

-Vërejtje: në këtë tabelë të hyrat e realizuara për vitet 2020 dhe 2021 janë pa gjobat e trafikut dhe gjykatave.

1.2 Të hyrat e rregullta të planifikuara dhe të realizuara në baza mujore 2021/2020 dhe krahasimi i tyre.

Periudha	Realizimi 2020	Planifikimi 2021	Realizimi 2021	Ndryshimi Realizimi/Planifikim 2021	Përqindja e Realizimit 2021
	1	2	3	3/1	3/2
Janar	73,433.20	88,424.42	79,206.53	(9,217.89)	(10.42)
Shkurt	90,756.67	88,424.42	85,381.57	(3,042.85)	(3.44)
Mars	80,321.71	88,424.42	116,898.68	28,474.26	32.20
Prill	19,328.99	88,424.42	107,245.33	18,820.91	21.28
Maj	27,181.24	88,424.42	81,201.86	(7,222.56)	(8.17)
Qershor	113,580.53	88,424.42	78,604.19	(9,820.23)	(11.11)
Korrik	102,990.93	88,424.42	93,519.12	5,094.70	5.76
Gusht	119,444.48	88,424.42	147,698.34	59,273.92	67.03
Shtator	175,103.89	88,424.42	133,644.70	45,220.28	51.14
Tetor	148,026.92	88,424.42	77,759.24	(10,665.18)	(12.06)
Nëntor	101,225.31	88,424.42	58,088.34	(30,336.08)	(34.31)
Dhjetor	131,329.86	88,424.42	113,391.08	24,966.66	28.24
Totali	1,182,723.25	1,061,093.04	1,172,638.98	111,545.94	110.51

1.3 Krahasimi i të hyrave të rregullta të realizuara në baza mujore 2015-2021.

Periudha	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Janar	59,440.11	53,093.33	65,258.72	71,296.21	67,441.16	73,433.20	79,206.53
Shkurt	63,104.60	72,122.01	53,970.89	79,441.98	101,728.36	90,756.67	85,381.57
Mars	73,504.67	107,024.34	123,917.27	100,586.69	77,787.87	80,321.71	116,898.68
Prill	55,312.19	92,147.11	67,409.06	74,037.40	88,525.55	19,328.99	107,245.33
Maj	59,445.79	60,471.16	86,337.92	64,983.12	90,937.21	27,181.24	81,201.86
Qershor	63,009.17	61,909.92	55,212.16	65,779.79	102,804.51	113,580.53	78,604.19
Korrik	55,394.10	64,357.38	69,950.39	72,593.52	84,884.33	102,990.93	93,519.12
Gusht	87,316.76	124,730.19	84,523.01	88,320.39	103,839.12	119,444.48	147,698.34
Shtator	60,011.56	59,255.33	61,105.72	66,711.18	132,861.21	175,103.89	133,644.70
Tetor	74,774.15	57,533.96	47,580.23	101,089.81	84,831.76	148,026.92	77,759.24
Nëntor	50,566.81	45,968.14	43,733.25	120,636.00	74,520.11	101,225.31	58,088.34
Dhjetor	101,278.13	79,221.00	61,867.85	89,372.11	93,241.70	131,329.86	113,391.08
